

## RELACION TEKNIK

**OBJEKTI:** - "*Veshje betoni ne kanale ujites ne zonat rurale*".

VENDNDODHJA : Kanali ujites i Gurakuqit , Fshati Shushice , Njesia Administrative Shushice ; Kanali ujites sekondar ku.02 dhe ku.02/1 Polis-Tudan (Shushice) , Fshati Shushice , Njesia Administrative Shushice ; Kanali ujites ku.Kozan sekondar rezervuarve Funar , Fshati Kozan ,Njesia Administrative Bradashesh ; Kanali ujites ku.Karakullak sekondar rezervuari Funar ,Fshati Karakullak , Njesia Administrative Bradashesh ; Kanali ujites sekondar ku.23/1 Fshati Jakodine , Njesia Administrative Shirgjan

QELLIMI: Funkionimi normal të infrastrukturës së ujitjes dhe përmirësimin e treguesve të tij dhe mirëmbajtja periodike e tij nga përfituesi projektit Bashkia Elbasan

Hartimi i projekteve "*Veshje betoni ne kanale ujites ne zonat rurale , Njesia Administrative Shushice , Bradashesh, Shirgjan, Bashkia Elbasan*" synon reabilitimin e kanaleve ujites nepermjet realizimit te veshjes me beton të kanalit, ndertim dhe vënien në funksion të veprave të artit dhe vënien e tyre në gatishmëri për ujitjen e tokave bujqësore.

### PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES

**Kanali ujitës KU.Gurakuqit** ndodhet ne fshatin Shushice ,Njesia Administrative Shushice sherben per vaditjen e tokave bujqesore te fshatit Shushice . Burimi i ujit eshte Lumi Shkumbin me ane te vepres se marrjes ne kete lume dhe ka gjatesi totale  $L = 9$  km eshte ndertuar rreth viteve 30-te dhe eshte i pa veshur dhe pa reabiltuar qe nga ndertimi i tij deri me sot. Siperfaqja qe mbulon kanali ujites i Gurakuqit eshte 80 ha. Me kete projekt synohet eliminimi i filtrimeve te kanalit ne nje gjatesi prej 144 ml ne pjesen qe kalon mbi shtepite e lagjjes Baldavere e cila eshte bere problematike per kete lagjje gjate kohes se vaditjes pasi si pasoje e filtrimeve kemi futje te ujit ne themelet e shtepive te kesaj lagjje cka rrezikon aktivizimin e fenomenit te rreshqitjes se tokes ku jane ndertuar rreth 15 shtepi banimi.

Foto ( gjendja ekzistuese )KU. Gurakuqit



Njekohesisht veprat e artit te te ndertuara pa projekt nuk trasportojne sasine e duhur te ujit për vaditjen e tokave, dhe mosfunksionimi i tij krijon probleme dhe rrezikon prodhimet bujqësore të zones fshatit Shushice, Njesia Administrative Shushice. Sipërfaqja që pritët të përmirësohet në vaditje është 80 ha toke bujqësore me prodhimtari maksimale.

Kulturat bujqësore më të përdorshme në këtë zonë mund të përmendim grurin, misrin, pataten, fasulen, domaten, specat, qepën dhe foragjeret të cilat rriten në mënyrë natyrale dhe pa konservantë apo ndikime të hormoneve për zhvillim të shpejtë.

**Kanali ujitës KU.02 Sekondar Polis -Tudan** me gjatesi totale  $L = 1550$  ml ndodhet ne fshatin Shushice, Njesia Administrative Shushice sherben per vaditjen e tokave bujqesore te fshatit Shushice. Pjesa e kryesore kanalit me gjatesi 1080 ml eshte rehabilituar (veshur me beton dhe ndertuar veprat e

artit) nga Banka Boterore ne vitet 2004-2006 dhe pjese e mbetur e pareabilituar eshte me gjatesi  $l = 470\text{ml}$ . Ne kete projekt prarashikohet reabilitimi i segmentit nga priza ne kryqezimin per ne lagjen Baldavere deri ne kanalin ujites te Gurakuqit  $l = 180\text{ ml}$ . Burimi i ujit eshte priza e marrjes ne kanalin ujites Polis -Tudan. Ky kanal kryen vaditjen në një sipërfaqe prej 30 ha në këtë zone dhe njekohesisht sherben per te furnizuar edhe kanalin ujites te Gurakuqit.

Hartimi i projektit bëhet që kanali i mësipërm të bëjë përmirësimin e vaditjes të siperfaqes prej 30 ha toke bujqësore pasi ai te dimensjonohet dhe rikonstruktohet në parametra normal për një funksionim më të mirë të tij. Sipërfaqja që pritet të përmirësohet është 30 ha të projektuar pasi kjo gjatësi kanali ka përqëndrimin më të madh të tokave bujqësore me prodhimtari maksimale.

Kulturat bujqësore më të përdorshme në këtë zonë mund të përmendim grurin, misrin, pataten, fasulen, domaten, specat, qepën dhe foragjeret të cilat rriten në mënyrë natyrale dhe pa konservantë apo ndikime të hormoneve për zhvillim të shpejtë.

*Foto ( gjendja ekzistuese )KU. 02Sekondar Pols -Tudan*



**Kanali ujitës KU.02/1 Sekondar Polis -Tudan** me gjatesi totale  $L = 532$  ml ndodhet ne fshatin Shushice, Njesia Administrative Shushice sherben per vaditjen e tokave bujqesore te fshatit Shushice. Pjesa e kryesore kanalit me gjatesi  $l = 437$  ml eshte rehabilituar (veshur me beton dhe ndertuar veprat e artit) nga Banka Boterore ne vitet 2004-2006 dhe pjese e mbetur e pareabilituar eshte me gjatesi  $l = 95$  ml. Ne kete projekt prarashikohet rehabilitimi i segmentit fundor te kanalit ujitës gjatesi  $l = 95$  ml ndodhet ne fshatin Shushice ,Njesia Administrative Shushice sherben per vaditjen e tokave bujqesore te fshatit Shushic. Burimi i ujit eshte kanali ujitës ku.02 Sekondar Polis -Tudan me prizen ne kryqezimin e rruges se lagjes Baldavere .Ky kanal kryen vaditjen në një sipërfaqe prej 12 ha në këtë zone dhe njekohesisht sherben per te furnizuar edhe kanalin ujitës te Gurakuqit. Hartimi i projektit bëhet që kanali i mësipërm të bëjë përmirësimin e vaditjes te siperfaqes prej 15 ha toke bujqësore pasi ai te dimensionohet dhe rikostruktohet në parametra normal për një funksionim më të mirë të tijë.

*Foto ( gjendja ekzistuese )KU. 02/1Sekondar Pols -Tudan*





Kulturat bujqësore më të përdorshme në këtë zonë mund të përmendim grurin, misrin, pataten, fasulen, domaten, specat, qepën dhe foragjeret të cilat rriten në mënyrë natyrale dhe pa konservantë apo ndikime të hormoneve për zhvillim të shpejtë.

**Kanali ujitës i Karakullakut** ndodhet ne fshatin Karakullak ,Njesia Administrative Bradashesh sherben per vaditjen e tokave bujqesore te fshatit Karakullak . Burimi i ujit eshte Perroi i Kushes i cili furnizohet nga Rezervuaret e Funarit dhe marrja e ujit ne Perroin e Kushes behet me ane te vepres se marrjes provizore me materjale dheu dhe qe ndertohet gjate cdo sezonit te vaditje. Kanali ujites Karakullak ka gjatesi totale  $L = 1560\text{ml}$  eshte ndertuar rreth viteve 40-te. Pjesa e pare nga vepra e marries deri ne piketen Pk.5 me gjatesi  $l = 86\text{ ml}$  eshte e veshur me beton gjate vitit 2021.Njekohesisht ne vitin 2021 eshte nderhyre per ndertimin e veprave te artit te ketij kanali , jane ndertuar nenkalimet , mbikalimet, barazhet dhe prizat e marrjes se ujit dhe ka ngelur reabilitimi i seksjonit trasportues te kanalit ( veshja me beton e seksjonit ) me gjatesi  $l = 1414\text{ ml}$  . Siperfaqja qe mbulon kanali ujites i Karakullakut eshte 65 ha. Me kete projekt synohet eliminimi i filtrimeve te kanalit dhe rritja e aftesise ujites nepermjet shtimit te prurjes se ujit pasi ky kanal edhe pse ka qene pjesisht funksjonal në zonën e Karakullakut nuk e ka kryer funksionin plote te tij për vaditjen e tokave per arsye te mos reabilitimit ne vite ka pasur shume humbje te ujit gjate gjithe gjatesise se tij dhe mosfunksionimi i tij krijon probleme dhe rrezikon prodhimet bujqësore të zonës. Kulturat bujqësore më të përdorshme në këtë zonë mund të përmendim grurin, misrin, pataten, fasulen, domaten, specat, qepën, të cilat rriten në mënyrë natyrale dhe pa konservantë apo ndikime të hormoneve për zhvillim të shpejtë.

Nga frutikulturat e zonës mund të përmendim rrushin, kumbullën, mollën, ullirin, etj.

Ky kanal kryen vaditjen në një sipërfaqe te konsiderueshme në këtë zone e cila ka përqëndrimin më të madh të tokave bujqësore me prodhimtari maksimale.

Hartimi i projektetit bëhet që kanali i mësipërm të bëjë përmirësimin e vaditjes të sipërfaqes prej 65 ha tokave bujqësore dhe kthen kanalin në parametra normal për një funksionim më të mirë të tyre.

Foto ( gjendja ekzistuese )KU. Karakullak Sekondar i kanalit ujites rezervuareve Funar



**Kanali ujitës i Kozan** ndodhet ne fshatin Kozan, Njesia Administrative Bradashesh sherben per vaditjen e tokave bujqesore te fshatrave Balez e sipërme, Balez e poshtme dhe Kusarth. Burimi i ujit është kanali ujites KU2 i rezervuarit 3-3 Funar me ane te sifonit ne kete kanal dhe ka gjatesi totale  $l = 2970$  ml është ndertuar rreth viteve 80-te. Njekohesisht ne vitin 2020 është nderhyre per ndertimin e veprave te artit dhe veshjen e pjeses fundore te ketij kanali .Ne pjesen e mbetur me gjatesi  $l = 1980$  ml jane ndertuar, nenkalimet mbikalimet, barazhet dhe prizat e marrjes se ujit dhe ka ngelur reabilitimi i seksionit trasportues te kanalit (veshja me beton e seksjonit) nga piketa Pk.1- Pk37 me gjatesi  $l = 1397$  ml. Siperfaqja qe mbulon kanali ujites i Kozan është 100 ha. Me kete projekt synohet eliminimi i filtrimeve te kanalit dhe rritja e aftesise ujites nepermjet shtimit te prurjes se ujit pasi ky kanal edhe pse ka qene pjeserisht funksjonal në zonën e Balez e sipërme, Balez e poshtme dhe Kusarth dhe nuk e ka kryer funksionin plote te tij për vaditjen e tokave per arsye te mos reabilitimit ne vite ka pasur shume humbje te ujit gjate gjithë gjatesise se tij dhe mosfunksionimi i tij krijon probleme dhe rrezikon prodhimet bujqësore të zonës.

Kulturat bujqësore më të përdorshme në këtë zonë mund të përmendim grurin, misrin, pataten, fasulen, domaten, specat, qepën, të cilat rriten në mënyrë natyrale dhe pa konservantë apo ndikime të hormoneve për zhvillim të shpejtë.

Nga frutikulturat e zonës mund të përmendim rrushin, kumbullën, mollën, ullirin, etj.

Foto (gjendja ekzistuese)KU. Kozan, Sekondar i kanalit ujites rezervuareve Funar



Ky kanal kryen vaditjen në një sipërfaqe të konsiderueshme në këtë zonë e cila ka përqëndrimin më të madh të tokave bujqësore me prodhimtari maksimale.

Hartimi i projektetit bëhet që kanali i mësipërm të bëjë përmirësimin e vaditjes të 100 ha tokave bujqësore dhe kthen kanalin në parametra normal për një funksionim më të mirë të tyre.

**Kanali ujitës i 23/1 Jakodine** ndodhet në fshatin Jakodine, Njesia Administrative Shirgjan shërben për vaditjen e tokave bujqësore të fshatit Jakodine. Burimi i ujit është Kanali ujites ku. 23 Ferras me ane të prizës së marrjes së ujit në këtë kanal dhe ka gjatësi totale  $L = 586$  ml është ndërtuar rreth viteve 70-te. Për rehabilitimin e kanalit është investuar në vitet 2018 dhe 2019 për veshjen e kanalit me gjatësi  $l = 336$  ml të pjesës për të këtij kanali dhe ndërtimin e veprave të artit nënkallimet mbikalimet, barazhet dhe prizat e marrjes së ujit dhe ka ngelur rehabilitimi i seksjonit transportues të pjesës fundore të kanalit (veshja me beton të seksjonit) me gjatësi  $L = 250$  ml. Sipërfaqja që mbulon kanalin ujites 23/1 Jakodine është 50 ha. Me këtë projekt synohet eliminimi i filtrimeve të kanalit dhe rritja e aftësisë ujtesë nëpërmjet shtimit të prurjes së ujit pasi ky kanal edhe pse ka qenë pjesërisht funksional në pjesën fundore të tij dhe nuk e ka kryer funksionin plotë të tij për vaditjen e tokave për arsye të mos rehabilitimit në vite ka pasur shumë humbje të ujit gjatë gjithë gjatësisë së tij dhe mos funksionimi i tij krijon probleme dhe rrezikon prodhimet bujqësore të zonës.

Kulturat bujqësore më të përdorshme në këtë zonë mund të përmendim grurin, misrin, fasulen, domaten, specat, qepën, të cilat rriten në mënyrë natyrale dhe pa konservantë apo ndikime të hormoneve për zhvillim të shpejtë.

*Foto ( gjendja ekzistuese )KU. 23/1Jakodine*







## **QËLLIMI I PROJEKTIT**

- Ky projekt kryhet për riaftësimin e mirëfunksionimit të infrastrukturës së ujitjes, përmirësimin e treguesve të tij. Kthimi i këtyre treguesve në parametrat normalë bën që të kemi vadtje të plotë të tokave.
- Të hartohen projektet e zbatimit e reabilitimit te plote te kanaleve sipas parametrave të projekteve fillestare dhe pastrohen kanalet ujitëse.
- Të realizohet planifikimi i mirëmbajtjes periodike vjetore nga ana e pronarit , përfituesit dhe investitorit që në këtë rast është Bashkia Elbasan, në mënyrë ruajtjen e investimit të kryer në këtë objekt si dhe funksionimin e tij të plotë e njëkohësisht marrjen e masave për reabilitimin e pjesës që nukpërfshihen në fazën e parë të investimit që kërkohet të realizohet.

## **METODIKA E HARTIMIT TË PROJEKTIT**

Në mënyrë kronologjike projekti ka kaluar në këto faza:

- ✦ Është filluar me azhornimin paraprak për përcaktimin e skemës ujitëse në përgjithësi.
- ✦ Është bërë azhornimi topografik , bazuar në skemën ujitëse
- ✦ Është bërë ballafaqimi i topografisë me gjendjen aktuale duke shkelur të gjithë gjatësinë e kanalit për të bërë pastrimin sa më të saktë të tij

- ✦ Është bërë ballafaqimi i topografisë me gjendjen aktuale duke shkelur të gjithë gjatësinë e kanalit për të bërë pastrimin sa më të saktë të tij.
- ✦ Përpunimi i materialeve në nivel projekt zbatimi duke hartuar një planimetri me të gjitha veprat egzistuese dhe të reja ne Sh. 1:4.000, 1:1.000
- ✦ Profili Gjatesor ne SH.V 1:100, SH.H 1:1000
- ✦ Detaje SH. 1:25 – 1:50

## **VOLUMET E PUNIMEVE**

Rehabilitimi i kanalit ujitës objekt i detyrës të projektimit përfshin pastrimin e kanaleve nga shkuret, si dhe gërmimin për rixeksionim të tyre si dhe transportin e dherave nga anët e kanalit për të mos krijuar problem me rrugen dhe banorët e zonave përkatëse si dhe veshjen e tij me beton ne segmente e treguara ne projekt dhe ndertimin e veprave te artit.

Volumet e punimeve janë nxjerë nga profilat gjatësor dhe sipas seksioneve tërthore.

Janë bërë llogaritjet e kuotave, të tabanit ose mbushjes dhe kuota e projektit me qëllim funksionimin sipas parametrave të projektuar për seksionet.

## **KONKLUZIONE**

Në përfundim të projektit për objektin në studim për rehabilitim konkludojmë si më poshtë:

1. Janë hartuar planimetritë e përgjithshme, profilat gjatësor, profilat tërthor për çdo piketë.
2. Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas V.K.M. Nr.629 datë 15.07.2015.
3. Analizave të çmimeve dhe normativave të tregut në Rajonin Elbasan

## **REKOMANDIME**

1. Përpara fillimit të punimeve duhet të bëhet piketimi sipas gjendjes së momentit kur jepet investimi.
2. Të bëhet edhe njëherë azhurnimi topografik para fillimit të punimeve dhe të krahasohet me profilat tërthorë e gjatësorë të kanaleve.
3. Të zbatohen me korrektësi KTP dhe KTZ gjatë punimeve, çdo ndryshim në projekt të bëhet në miratim të plotë me investitorin dhe projektuesin në rastet që do të jetë e nevojshme një gjë e tillë.

## **PREVENTIVI I PUNIMEVE**

Preventivi i përfundimit të punimeve për objektin " *Veshje betoni ne kanale ujitesë ne zonat rurale, Bashkia Elbasan* " është bashkëlidhur projekt-zbatimit që shoqëron këtë relacion.

Specialist: Ing.Ndricim Sinani

Specialist: Ing.Arian Baku

Specialist: Ing.Armand Topi

Topograf: Myfit Hyseni

**Miratoi Drejtori A.SH.P Edvin Palloshi**